



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

---

Numri i lëndës: 2020:051661

Datë: 03.02.2025

Numri i dokumentit: 06796187

**C. nr.418/2020**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEGA NË KAMENICË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**, përmes gjyqtarës Valbonë Dërvodeli, me bashkëpunëtorin profesional Blerand Sopi, në çështjen juridike kontestimore të paditësve, F. B. dhe A. D., të cilët me autorizim i përfaqëson Kushtrim Bunjaku, avokat në Gjilan, kundër të paditurës Komuna e Kamenicës – Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, me objekt kontesti për kompensimin e simulimit, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik, në prezencën e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, më datën 24.01.2025 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET PJESËRISHT** si e bazuar kërkesëpadia e paditësve, F. B. dhe A.D. :

**II. DETYROHET** e paditura Komuna Kamenicës - Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, që në emër të kompensimit në të ardhura personale për punën në terren–punte–Stimulimin në punë, - paditëses **F.B.** për periudhën kohore nga data 29.04.2017 deri me datë 31.05.2018 të ia paguaj shumën prej 2,028.92 Neto, si dhe në Trustin Pensional të Kosovës ti paguhet shuma prej 144.08 Euro në emër të kontributeve pensionale nga ana e punëdhënësit dhe e punëmarrësit si dhe në Administratën Tatimore të Kosovës ti paguhet shuma prej 273.74 euro në emër të tatimit në burim,

- paditësit **A. D.** për periudhën kohore nga data 29.04.2017 deri me datë 31.05.2018 të ia paguaj shumën prej 3,887.78 Neto, si dhe në Trustin Pensional të Kosovës ti paguhet shuma prej 237.24 Euro në emër të kontributeve pensionale nga ana e punëdhënësit dhe e punëmarrësit si dhe në Administratën Tatimore të Kosovës ti paguhet shuma prej 450.76 euro në emër të tatimit në

burim, të gjitha këto me kamatë ligjore 8% nga dita e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën përfundimtare.

**III. REFUZHET** e pa bazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses **F. B.** e kërkuar përtej shumës së aprovuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, për periudhën Qershor 2015 – Mars 2017 në shumën prej 3,188.29 euro, ndërsa për **A. D. REFUZHET** e pa bazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë e kërkuar përtej shumës së aprovuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, për periudhën Qershor 2015 – Mars 2017 në shumë prej 169.02 euro.

**IV. DETYROHET** e paditura, që paditësve në emër të kompensimit të shpenzimeve të procedurës kontestimore, t'ia paguaj shumën prej 815.00 euro, në afat prej 7 (shtatë) ditësh, pas datës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me detyrim.

### **A r s y e t i m**

Paditësit, F. B.dhe A.D.. më datën 29.04.2020, në këtë gjykatë kanë paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Kamenicës – Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, me objekt kontesti për kompensimin e simulimit.

#### **1. Pretendimet e palëve ndërgjyqëse**

I autorizuari i palëve paditëse, avokati Kushtrim Bunjaku nga Gjilani, në seancën përgatitore dhe gjatë seancave të shqyrtimit kryesor, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, duke i propozuar gjykatës që të aprovohet kërkesëpadia e paditësve, pas administrimit të provave është vërtetuar themelësia e kërkesëpadisë, ashtu që nga kontrata e punës, vërtetimin mbi periudhën kohore të punuar në punë shëndetësore dhe lista e pagesës është vërtetuar fakti se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura dhe se kanë punuar në punkte shëndetësore dhe shihet paga mujore e realizuar. Njëherit ka kërkuar nga gjykata që paditësve në emër në emër të kompensimit të stimulimit në punë komfor UA me nr.04/07 të nxjerrë nga ministria e shëndetësisë paditësve t'ua paguaj shumën e përcaktuar si në parashtrësën për precizimin e padisë të dorëzuar më datë 23.12.2024. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar edhe atë, për përpilimin e padisë 104 euro, për taksën gjyqësore 21 euro, për përpilimin e ekspertizës financiare 150 €, si dhe për katër seanca gjyqësore nga 135 euro apo në shumë prej 540 euro, apo në shumë të përgjithshme prej 846 euro.

I autorizuari i së palës së paditur, në seancën përgatitore dhe gjatë seancave të shqyrtimit kryesor, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi, e kundërshtojnë në tërësi kërkesëpadinë e paditësve si për nga baza ligjore ashtu edhe për nga provat e dorëzuara në padi, duke konsideruar se paditësit nuk e kanë argumentuar me prova të mjaftueshme punën e tyre në teren apo në punkte dhe për këtë arsyeje mendon se nuk plotësohen kushtet që të njëjtëve tu njihet kjo e drejtë. Ekspertiza financiare është e pa çart për faktin se cilat janë shumat të cilat i takojnë paditësve në emër të 30% të pagës bazë gjatë periudhave kohore në të cilat paditësit pretendojnë se kanë punuar në punkte të largëta. Andaj gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë e paditësve ta refuzoj në tërësi si të pa bazuar, duke marrë parasysh mungesën e provave për vërtetimin e fakteve vendimtare, si dhe parashkrimin e kërkesave të paditësve. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar edhe atë, shumën prej 1352 për mbajtjen e pesë seancave si dhe shumën prej 312 euro për përgjigjen në padi.

## **2. Provat e administruara në shqyrtimin kryesor**

Gjykata për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore në procedurën e provave i ka administruar këto prova: Kontrata e punës ne emër të Dr. F. B. me nr.08-302, te dt.11.08.2015, Vërtetimi i Qendrës kryesore te mjekësisë familjare “Dr.Shaban Geci” Kamenicë, me nr.08/620 i dt.20.11.2019, Kontrata e punës ne emër të Dr. A.D. me nr.08-119, te dt.13.03.2014, Vendimi mbi sistemimin e te punësuarit në emër të Dr. A. D. me nr.08-105, të dt.27.02.2019, Vendimi mbi sistemimin e përkohshëm te punësuarit në emër të Dr. A. D. me nr.08-410, te dt.22.09.2014, Udhëzimi Administrativ 04/2017, i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë për Ekonomi dhe Financa, Regjistri nga lista e pagave ne emër të A. D. dhe F. B., Orari i punës për muajin Dhjetor te vitit 2015, Nëntor i vitit 2015, Tetor i vitit 2015, Shtator i vitit 2015, Gusht i vitit 2015, Korrik i vitit 2015, Qershor i vitit 2015, Janar, Shkurt, Mars, Prill, Maj, Qershor, Korrik, Gusht, Shtator, Nëntor, Dhjetor i vitit 2016, Janar, Shkurt, Mars, Prill, Maj, Qershor, Korrik, Gusht, Shtator, Tetor, Nëntor, i vitit 2017, Janar, Shkurt, Mars, Prill, Maj i vitit 2018, Regjistri i punëtoreve QKMF ne Prishtine te cilët punojnë neper QMF dhe ambulanca jashtë QKMF-së dhe kane te drejte ne kompensim 30 % te pagës për kushte te vështira pune për muajin Qershor 2016, Vendimi i QKMF ne Gjilan i dt.04.06.2014, për kompensimin e simulimit për punë ne punkte largëta, Njoftimi i QKMF “Dr. Shaban Geci” në Kamenice me nr. te ref.08/284 i dt.19.08.2024, Ekspertiza financiare e dt.17.09.2024, Korrigjimi i ekspertizës financiare i dt.05.12.2024, Aktgjykimi i Gjykatës Themelore Gjilan –

Dega ne Kamenice C.nr. 54/2015 i dt.10.07.2017 dhe aktgjykimi AC.nr.4639/2017 i dt.16.10.2019 i Gjykatës se Apelit te Kosovës ne Prishtinë.

Pasi që gjykata e bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, komfor dispozitës së nenit 8, të LPK-së, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi për këto arsye:

Për palët ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësit kanë punuar në teren nga datat 01.06.2015 deri me datë 31.05.2018, ngase një fakt i tillë vërtetohet me konfirmimin e datës 19.08.2024 të lëshuar nga vetë e paditura.

### **2.1. Provat materiale**

Në bazë kontratës së punës ne emër të Dr. F.B. me nr.08-302, te dt.11.08.2015, gjykata vërtetoi faktin se paditësja F. B., me paditësen Komunën e Kamenicës- Qendra e Mjekësisë Familjare, ka lidhur kontratë si Mjek i Përgjithshëm, me afat të pacaktuar, me 40 orë pune në javë.

Në bazë të vërtetimit të Qendrës kryesore te mjekësisë familjare “Dr.Shaban Geci” Kamenicë, me nr.08/620 i dt.20.11.2019, gjykata vërtetoi faktin se paditësja F. B. është në marrëdhënie pune tek e paditura Komuna e Kamenicës- Qendra e Mjekësisë Familjare, në afat të pa caktuar. Po ashtu e njëjta nga data 01.06.2015 deri më datë 31.05.2018 ka punuar në teren, respektivisht në fshatrat malore të Komunës së Kamenicës.

Në bazë kontratës së punës në emër të Dr. A. D. me nr.08-119, te dt.13.03.2014,, gjykata vërtetoi faktin se paditësi A.D., me paditësen Komunën e Kamenicës- Qendra e Mjekësisë Familjare, ka lidhur kontratë si Mjek i Përgjithshëm, me afat të pacaktuar, me 40 orë pune në javë.

Në bazë të vendimit mbi sistemimin e të punësuarit në emër të Dr. A. D. me nr.08-105, të dt.27.02.2019, gjykata vërtetoi faktin se paditësi A. D. është sistemuar përkohësisht si Specialist i Mjekësisë Familjare në QKMF-Kamenicë, me kohë të caktuar 1 mujore.

Në bazë të vendimit mbi sistemimin e përkohshëm te punësuarit në emër të Dr. A. D. me nr.08-410, te dt.22.09.2014, gjykata vërtetoi faktin se paditësi A. D. është sistemuar përkohësisht dhe me pëlqimin e tij, si Mjek në teren në QKMF-Roganë, me kohë të caktuar edhe atë prej 22.09.2014 deri 22.09.2015.

Në bazë të Orarit të punës për muajin Dhjetor te vitit 2015, Nëntor i vitit 2015, Tetor i vitit 2015, Shtator i vitit 2015, Gusht i vitit 2015, Korrik i vitit 2015, Qershor i vitit 2015, Janar, Shkurt, Mars, Prill, Maj, Qershor, Korrik, Gusht, Shtator, Nëntor, Dhjetor i vitit 2016, Janar, Shkurt, Mars, Prill, Maj, Qershor, Korrik, Gusht, Shtator, Tetor, Nëntor, i vitit 2017, Janar, Shkurt, Mars, Prill, Maj i vitit 2018, gjykata vërtetoi faktin se që të dy paditësit janë pjesë e të gjitha këtyre Orareve të lartcekura.

Në bazë të vendimit i QKMF ne Gjilan i dt.04.06.2014, për kompensimin e simulimit për punë ne punkte largëta, gjykata vërtetoi faktin se në bazë të këtij vendimi i lejohet stimulimi punëtorëve të cilët punojnë në punkte të largëta shëndetësore që janë mbi 5 km larg qendrës më të afërt të Mjekësisë Familjare, që stimulimi ti kompensohet në mënyrë retroaktive 30% nga data 01.07.2012 sipas kuotës 25. par. 1.11 i Kontratës Sektoriale, dhe ky kompensim është bërë në emër të Dr. N.H. dhe Dr. A. M..

Në bazë të njoftimit të QKMF “Dr. Shaban Geci” në Kamenice me nr. te ref.08/284 i dt.19.08.2024, gjykata vërtetoi faktin se paditësja Dr. F. B. ka punuar në teren nga datat 01.06.2015 deri 31.05.2018 ndërsa Dr.A.D.ka punuar në teren nga datat 01.03.2017 deri më 28.02.2019.

Në bazë të ekspertizës financiare e dt.17.09.2024, Korrigjimi i ekspertizës financiare i dt.05.12.2024, të punuara nga eksperti R. Sh. gjykata vërtetoi faktin se, në bazë të ekspertizës, analizës dhe llogaritjen e bërë për periudhën nga Qershor 2015 deri në Maj 2018 për F. B. janë marrë parasysh të gjitha aspektet relevante, përfshirë pagën bruto-bazë 30% e pagës bazë, kontributet në trustin pensional, tatimin në pagë dhe të hyrat e realizuara bruto. Totali i të hyrave të realizuara bruto arrin në 6,407.10 euro duke përfshirë kontributet e punëdhënësit. Ndërsa për A. D. për periudhën Mars 2017 deri në Shkurt 2019 janë marrë parasysh të gjitha aspektet relevante, përfshirë pagën bruto-bazë 30% e pagës bazë, kontributet në trustin pensional, tatimin në pagë dhe të hyrat e realizuara bruto. Totali i të hyrave të realizuara bruto arrin në 4,982.04 euro duke përfshirë kontributet e punëdhënësit. Ndërsa në bazë të korrigjimit të ekspertizës gjykata vërtetoi faktin se paga bruto për F. B. është 6,102.00 euro. E paditura ishte e obliguar të paguajë kontributin pensional, i cili është 5% nga punëdhënësi dhe 5% nga punëmarrësi, që përkethehet ne 610.20 euro. Po ashtu, e paditura është e obliguar të paguajë tatimin ne burim (tatimi ne te hyrat personale), i cili është 579.69 euro. Pas heqjes së këtyre detyrimeve, paga neto për F. B. është 5,217.21 euro për periudhën nga Qershori 2015 deri ne Maj 2018. Ndërsa paga bruto për A. D. është 4,744.80 euro. E paditura është e obliguar të paguajë kontributin pensional,

i cili është gjithashtu 5% nga punëdhënësi dhe 5% nga punëmarrësi, që përkthehet në 474.48 euro. E paditura është e obliguar të paguajë tatimin në burim (tatimi në të hyrat personale), i cili është 0.76 euro. Paga neto për A. D. për periudhen nga Marsi 2017 deri në Shkurt 2019 është 4,056.80 euro, pas zbritjes së këtyre detyrimeve.

## **2.2. Deklarata e Ekspertit Financiar Rinor Shabani**

Eksperti financiar, Rinor Shabani në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 05.12.2024, ka deklaruar se mbetet pranë raportit dhe është i gatshëm të jep sqarime të detajuara, duke shtuar se gjate kalkulimeve që ka bërë nuk e ka bashkangjitur tabelën e kalkulimeve që e ka ardhur deri tek rezultati përfundimtar për paditësin A. D., dhe nga një kopje të kësaj table ia ka dorëzuar në këtë seance gjykatës dhe palëve. Të gjitha kalkulimet janë bërë që paga bruto plus 5% të kontribut dhënësit të paguaj në total paditësve dhe atë në mënyrë vullnetare të deklaroj këto të hyra dhe të paguaj kontributet dhe tatimin në page.

### **Baza juridike**

Në bazë të Ligjit të Punës me nr. Ligji Nr. 03/L-212, respektivisht nenit 3 paragrafi 1.13 është paraparë se “Paga është shpërblimi ose fitimi i çfarëdo niveli të llogaritur e shprehur në para për të punësuarin” ndërsa në nenin 55 paragrafi 1 dhe 2 është përcaktuar se “I punësuar i ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit; Të drejtën për pagë, pagën shtesë, kompensimin në pagë dhe të ardhurat e tjera, i punësuar i realizon sipas marrëveshjes së arritur me punëdhënësin për punën e kryer dhe kohën e kaluar në punë, të përcaktuar me Kontratën e Punës” ndërsa në nenin 10, paragrafi 1, të këtij ligji është paraparë se “kontrata e punës lidhet në formë të shkruar dhe nënshkruhet nga punëdhënësi dhe i punësuar. Kontrata përfshin elementet e përcaktuara sipas nenit 11 të këtij ligji”, ndërsa paragrafi 2 i po këtij ligji parasheh se “kontrata e punës mund të lidhet për: 2.1. një periudhë të pacaktuar; 2.2. një periudhë të caktuar; dhe 2.3. për punë dhe detyra specifike”, gjithashtu në nenin 17 paragrafi 1 përcaktohet se “I punësuar caktohet në vendin e punës, për të cilën ka lidhur Kontratë Pune”, ndërsa në paragrafin 2 përcaktohet se “Në rast të nevojës për ristrukturim apo organizim të ri të punës, i punësuar në pajtim me Kontratën e Punës mund të sistemohet në vend tjetër të punës që i përgjigjet përgatitjes profesionale, aftësisë së tij dhe nivelit të njëjtë të pagës, në pajtim me Kontratën e Punës” Po ashtu, duke u bazuar në dispozitën e nenit 78 paragrafi 1, të Ligjit të

Punës, me Nr. 03/L-2012, ku përcaktohet se *“I punësuari i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë te punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura”* ndërsa në paragrafin 2, të po këtij neni, përcaktohet se *“Punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afatin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimit të kërkesës”,* si dhe në bazë të paragrafit 3, të po të këtij neni *“Vendimi nga paragrafi 2. i këtij neni, i dorëzohet të punësuarit në formë të shkruar brenda afatit prej tetë (8) ditësh”,* po ashtu në dispozitën e nenit 79 të Ligjit të Punës së lartcekur, përcaktohet se *“Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente”,* si dhe në dispozitën e nenit 17 paragrafi 1, të të njëjtit Ligj, ku përcaktohet se *“I punësuari caktohet në vendin e punës, për të cilën ka lidhur Kontratë Pune”,* si dhe duke u bazuar në dispozitën e nenit 13 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (e cila ka hyrë në fuqi me 1 shtator 1953) ku përcaktohet se *“Çdo njeri të cilit i shkelen të drejtat dhe liritë e parashtruara në këtë konventë duhet të ketë një mjet ligjor efektiv para një autoriteti kombëtar, pavarësisht nga fakti se shkeljen e kanë kryer personat që veprojnë në cilësi zyrtare”,* gjykata erdhi në përfundim se padia dhe kërkesëpadia e paditësit aprovohet pjesërisht si e bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa me Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2007 (Në Shëndetësi) Mbledhja Dhe Shfrytëzimi i Mjeteve Nga Bashkë pagesat E Shfrytëzuesve Të Shërbimeve Shëndetësore Dhe Të Hyrave Vetanake Të Institucioneve Shëndetësore, në nenin 10 përcaktohet se *“Pagesa për punën gjatë kujdestarisë, punën e natës dhe stimulimi për punë në punkte të largëta 10.1. Puna gjatë kujdestarisë është definuar si obligim për të ofruar shërbime shëndetësore brenda institucionit shëndetësor gjatë 24 orëve: Ora e punës gjatë kujdestarisë në ditët e rregullta të punës do të paguhet për intervalin kohor prej tetë (08) orësh, për periudhën 23:00-07:00. Për kujdestarinë në ditën e rregullt të punës, lejohet një ditë e lirë, të nesërmen pas kujdestarisë. Ora e punës gjatë kujdestarisë në ditën e premte do të paguhet për gjashtëmbëdhjetë (16) orë të punës, për periudhën 15:00-07:00,) Ora e punës gjatë kujdestarisë në ditën e shtunë do të paguhet për 24 orë të punës, c për periudhën 07:00-07:00, d) Ora e punës gjatë kujdestarisë në ditën e diele do të paguhet për gjashtëmbëdhjetë (16) orë të punës, për periudhën 15:00-07:00. Për kujdestarinë në ditën e diele, lejohet një ditë e lirë, të hënën pas kujdestarisë. 10.2. Puna gjatë natës është definuar si obligim për të ofruar shërbime shëndetësore brenda institucionit shëndetësor gjatë natës, si pjesë e punës në ndërrime. a) Ora e punës gjatë natës, si pjesë e punës në ndërrime, do të paguhet për intervalin kohor prej 23.00-*

07.00. 10.3. Varësisht nga kategoria profesionale: a) Ora e punës gjatë kujdestarisë dhe ora e punës gjatë natës, do të paguhet 50 me tepër se sa ora e rregullt e punës, b) Ora e punës gjatë festave shtetërore, do të paguhet 75% më tepër se sa ora e rregullt e punës. 104 Për sqarim të këtij udhëzimi administrativ, si punkt i largët shëndetësor definohet institucioni shëndetësor i cili është mbi 5 km larg qendrës më të afërt të mjekësisë familjare. a) Varësisht nga kategoria profesionale, stimulimi për punë në punkte të largëta shëndetësore do të jetë në vlerë prej 30% të pagesës së rregullt mujore, 10.5. Parakusht për pagesat e lartpërmendura është plotësimi i kuotës së plotë të orëve të punës të parapara për një muaj.

### 3. Vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Duke i pasur parasysh provat materiale, të cekura si më lartë, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësve F. B. dhe A. D., është pjesërisht e bazuar në ligj, ashtu që në bazë të këtij konstatimi gjykata ka vendosur që kërkesëpadinë e paditësve, përmes së cilës kanë kërkuar që paditësve të iu paguhet kompensimi në emër të stimulimit për punën në teren dhe atë në lartësi prej 30% të pagës bazë, ta aprovojë pjesërisht si të bazuar, dhe atë për paditësen **F. B.** për periudhën kohore nga data 29.04.2017 deri me datë 31.05.2018 të ia paguaj shumën prej 2,028.92 Neto, si dhe në Trustin Pensional të Kosovës ti paguhet shuma prej 144.08 Euro në emër të kontributeve pensionale nga ana e punëdhënësit dhe e punëmarrësit si dhe në Administratën Tatimore të Kosovës ti paguhet shuma prej 273.74 euro në emër të tatimit në burim, dhe për Paditësin **A.D.** për periudhën kohore nga data 29.04.2017 deri me datë 31.05.2018 të ia paguaj shumën prej 3,887.78 Neto, si dhe në Trustin Pensional të Kosovës ti paguhet shuma prej 237.24 Euro në emër të kontributeve pensionale nga ana e punëdhënësit dhe e punëmarrësit si dhe në Administratën Tatimore të Kosovës ti paguhet shuma prej 450.76 euro në emër të tatimit në burim, të gjitha këto me kamatë ligjore 8% nga dita e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën përfundimtare.

Ndërsa kërkesëpadinë e paditësve me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditëses **F. B.** të ja paguaj shumën, për periudhën Qershor 2015 – Mars 2017 në shumën prej 3,188.29 euro, ndërsa për **A. D.** të ja paguaj, për periudhën Qershor 2015 – Mars 2017 në shumë prej 169.02 euro, gjykata e ka refuzuar si të pa bazuar, për arsye të parashkrimit.

Kështu sipas nenit 87 të Ligjit të Punës shprehimisht theksohet që “Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”. Në këtë drejtim, paditësit padinë pranë kësaj gjykate e ka parashtruar më datë



29.04.2020 e rrjedhimisht, duke vlerësuar afatin 3 vjeçar për parashkrimin e kërkesës në fjalë, gjykata erdhi në përfundim se paditësit iu ka parashkruar pjesa e kërkesës për periudhën deri në muajin mars të vitit 2017.

Gjykata, bazën juridike të kërkesëpadisë së paditësve për kompensimin në emër të stimulimit, e ka vërtetuar në bazë të dispozitave ligjore të cekura si më lartë, ngase është fakt i pa kontestueshëm se i punësuar i cili angazhohet nga punëdhënësi për punë në punkte të largëta shëndetësore të pagesës së rregullt mujore, i takon edhe kompensimi në të holla në emër të kompensimit në vlerë prej 30% Ndërsa në anën tjetër gjykata, faktin se paditësit, respektivisht tani paditësit, F. B. dhe A. D., kanë kryer punën e përcaktuar me kontratë, me tani të paditurën Komuna e Kamenicës – Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Kamenicë, e ka vërtetuar në bazë të provës materiale, njoftimit të QKMF “Dr. Shaban Geci” në Kamenice me nr. te ref.08/284 i dt.19.08.2024, gjykata vërtetoi faktin se paditësja Dr. F.B. ka punuar në teren nga datat 01.06.2015 deri 31.05.2018 ndërsa Dr.A.D.ka punuar në teren nga datat 01.03.2017 deri më 28.02.2019.

Sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë së paditësve, të cilën gjykata ia ka njohur, sikurse në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata e ka vërtetuar në bazë të Ekspertizës Financiare të hartuar nga Eksperti Financiar Rinor Xh. Shabani, të cilës gjykata ja fali besimin e plotë ngase e njëjta në mënyrë të detajuar përmban përlllogaritjen lidhur me vlerësimin e saktë të pagave neto të papaguara dhe diferencën në kontributet pensionale si dhe në tatimin në burim.

Gjykata refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e kërkesëpadinë e paditësve me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditëses **F.B.** të ja paguaj shumën, për periudhën Qershor 2015 – Mars 2017 në shumën prej 3,188.29 euro, ndërsa për **A.D.** të ja paguaj, për periudhën Qershor 2015 – Mars 2017 në shumë prej 169.02 euro, ngase e njëjta është e përfshirë në parashkrim.

#### **4. Shpenzimet e procedurës kontestimore**

Gjykata, vendosi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore duke u mbështetur në dispozitën e nenit 452 paragrafi 1, të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe në bazë të Tarifës së zbatuar të Odes së Avokatëve të Kosovës, e që në rastin konkret gjykata erdhi në përfundim se paditësit duhet t’i njihen shpenzimet e procedurës dhe atë në shumën prej 815.00 euro si në specifikim nga vet i autorizuari i paditësve, në emër të përfaqësimit nga i autorizuari i tij në 4 (katër) seanca gjyqësore, për secilën seancë nga 135.00 euro dhe shumën prej 104 euro në emër të përpilimit të padisë, 21 euro për taksën gjyqësore për padi, shumën 150 euro në emër të ekspertizës

financiare, ndërsa shuma e kërkuar në shumë prej 31 euro përtej shumës së kërkuar, refuzohet si e pabazuar.

Nga të lartëcekurat e bazuar në dispozitat e lartëcekur, si dhe në dispozitën e nenit 143, paragrafi 1 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL  
2020:051661, 24.01.2025**

**G j y q t a r j a**  
**Valbonë Dërvodeli, d. V**

**KËSHILLË JURIDIKE:** kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, pas ditës së pranimit të të njëjtit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës, në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.